



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 68

Tiranë – E premte, 22 prill 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 21, datë 18.4.2016	Për shpalljen e thirrjes së dytë për financimin e projekteve, nga granti “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, për vitin 2016 4113
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve 22, datë 18.4.2016	Për miratimin e financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, Programi i Zhvillimit Vendor dhe Rajonal, shtylla I..... 4121
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve 23, datë 18.4.2016	Për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit “Shëndetësia”, thirrja e parë, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, për vitin 2016..... 4123
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve 24, datë 18.4.2016	Për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit “Rehabilitimi mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim”, thirrja e parë, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, për vitin 2016..... 4124
Kërkesë e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë nr. 1575/5, datë 12.4.2016	Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga vendosja e servitutit për Ndërtimin e Korridorit të Sistemit të Gazsjellësit dhe Korridori i ndërtimit në zonat Fier, Korçë, Devoll, Berat dhe Lushnjë (pjesë e projektit të gazsjellësit “Trans Adriatik”)..... 4126

**VENDIM****Nr. 21, datë 18.4.2016**

**PËR SHPALLJEN E THIRRJES SË
DYTË PËR FINANCIMIN E
PROJEKTEVE, NGA GRANTI
“INFRASTRUKTURA VENDORE DHE
RAJONALE”, PROGRAMI I ZHVILLIMIT
TË INFRASTRUKTURËS VENDORE
DHE RAJONALE, SHTYLLA I, PËR
VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes së dytë, për vitin 2016, drejtimi “Stimulimi i zonave dhe poleve potenciale, cluster zhvillimi”, për financimin e projekteve nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, sipas shtyllave, programeve dhe granteve të financimit, si më poshtë vijon:

1.1 Granti 1: “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2016, në vlerën 3 330 000 000 (tre miliardë e treqind e tridhjetë milionë) lekë.

1.2 Drejtimet e thirrjes së dytë, kriteret e aplikimit dhe financimit, detajohen në aneksin 1, dhe shtojcat 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur këtij vendimi

2. (Ri)shpalljen e thirrjes për drejtimin “Kohezioni territorial dhe zhvillimi rajonal”, duke qenë se në thirrjen I të projekteve të zhvillimit rajonal, për vitin 2016, sekretariati teknik nuk propozoi projekte për financim, nga aplikimet e paraqitura. Financimi i projekteve për këtë drejtim, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2016, bëhet sipas shtyllave, programeve dhe granteve të financimit, si më poshtë vijon:

2.1 Granti 1: “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonal, shtylla I, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2016, në vlerën 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë.

2.2 Drejtimet e thirrjes së dytë, kriteret e aplikimit dhe financimit, detajohen në aneksin 2, dhe shtojcat 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur këtij vendimi

3. Detajimin e kalendarit të aktiviteteve për shpërndarjen e grantit 3: “Mbështetje për ekonominë dhe masa të tjera”, sipas aneksit 3, bashkëlidhur këtij vendimi. Vlera e grantit 3, thirrja e parë, për vitin 2016, është në vlerën 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë.

4. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik e Rajonal, dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi**

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar,
Ministri i Financave	anëtar,
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar,
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar,
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar,
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar,
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar,
Ministri i Shëndetësisë	anëtar,
Ministri i Kulturës	anëtar,
Ministri i Mjedisit	anëtar,
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar,
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar,
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar,
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

**ANEKSI 1:****DREJTIMIT DHE KRITERET E APLIKIMIT DHE FINANCIMIT PËR THIRRJEN II, DREJTIMI “STIMULIMI I ZONAVE DHE POLEVE POTENCIALE, (“CLUSTER”) ZHVILLIMI”, Granti 1: “Infrastruktura vendore dhe rajonale”****1. Drejtimi i I, i thirrjes së dytë për financim është për:**

- a) Zhvillime infrastrukturore brenda një zone të caktuar, të një qyteti (zonë urbane apo rurale), duke përfshirë projekte si, pazare, shëtitore, bulevarde, sheshe, zona rrotull kalave e monumenteve, lulishte, parqe urbane, zona të hapura rekreative, qendra të reja (dytësore), ndërhyrje polifunksionale në zona (grupe funksionesh) me interes, në funksion të karakterit policentrik të qytetit, fshatra dhe grupe fshatrash me potencial turistik dhe agroturizëm (natyror e historik), duke ndërhyrë në ndërtimin e udhëve, shesheve, sistemeve të ndriçimit, sinjalistikës, etj.

1.1. Vlerat “tavan” të financimit dhe/ose bashkëfinancimit, për aplikimin dhe financimin e projekteve, janë si më poshtë vijnë:

- a) Për njësitë e qeverisjes vendore, me popullsi deri në 50,000 banorë, vlera e financimit do të jetë, jo më shumë se 150 000 000 (njëqind milion) Lekë për projekt. Listën e njësive të qeverisjes vendore, që janë brenda këtij niveli të popullsisë, e dërgon pranë sekretariatit teknik në Ministrinë e Zhvillimit Urban, Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore.
- b) Për njësitë e qeverisjes vendore me popullsi mbi 50,000 banorë vlera e financimit do të jetë, jo më shumë se 400 000 000 (katërqind milion) Lekë për projekt.
- c) Për Bashkinë e Tiranës, vlera e financimit do të jetë jo më shumë se 700 000 000 (shtatëqind milion) Lekë për projekt.

2. Drejtimi i II, i thirrjes së dytë për financim është për:

- a) Investime në infrastrukturën e lokale (rrugore/ndriçim publik, zona të shërbimit të varrimit, zona informale).

2.1. Vlerat “tavan” të financimit dhe/ose bashkëfinancimit, për aplikimin dhe financimin e projekteve, janë si më poshtë vijnë:**3. Për projektet e tipit “rrugë” (infrastrukturë rrugore), vlera e financimit do të jetë, jo më shumë se 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milion) Lekë për**

projekt¹. Aplikimi për financimin e projekteve të përmendura në pikën 1 dhe pikën 2, të këtij Aneksi, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore.

4. Vlera e grantit për financimin e projekteve të thirrjes II, për vitin 2016, të grantit për infrastrukturën vendore dhe rajonale, është:

- a) Granti i miratuar, sipas vendimit nr.1 i KZHR, datë 04.02.2016 “Për përcaktimin e buxhetit e të drejtimeve prioritare të fondit për zhvillimin e rajoneve dhe kalendarit të programeve të financimit, për vitin 2016”, për drejtimin “Stimulimi i zonave dhe poleve potenciale, cluster të zhvillimit”, në vlerën 3 100 000 000 (tre miliard e njëqind milion) Lekë, dhe
- b) Fondi i krijuar nga diferenca midis vlerave të projekteve të miratuara në vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve dhe vlerave të kontratave, pas lidhjes së kontratës, për projektet me cikël financimi 2015-2016, të grantit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, në vlerën 230 000 000 (dyqind e tridhjetë milion) Lekë, sipas vendimit nr.22, datë 18.04.2016, “Për miratimin e financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”.

ANEKSI 2:

DREJTIMET DHE KRITERET E APLIKIMIT DHE FINANCIMIT PËR DREJTIMIN “KOHEZIONI TERRITORIAL DHE ZHVILLIMI RAJONAL”, Granti 1: “Infrastruktura vendore dhe rajonale”

1. Drejtimi i thirrjes për financim është për:

- 1.1. Projekte të zhvillimit rajonal, të fokusuara në përmirësimin e infrastrukturës së ndërveprimit ekonomik, që adresojnë një nevojë të zhvillimit social-ekonomik rajonal, përmirësojnë aksesin rajonal, ndër-rajonal dhe rivitalizimin e qendrave rajonale.

2. Kriteret e aplikimit dhe financimit, janë si më poshtë vijnë:

- 2.1. Aplikimi për financimin e projekteve të përmendura në pikën 2 të Vendimit dhe pikën 1, të këtij Aneksi, bëhet nga dy ose më shumë njësi të qeverisjes vendore, me marrëveshje partneriteti të lidhur midis tyre, si dhe nga Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, agjencitë për zhvillimin rajonal nr.1, nr.2, nr.3 dhe nr.4, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me marrëveshje

¹ Përfashtim bëjnë projektet, që kanë marrë miratim në vitet paraardhëse, por që janë rishikuar për shkak të specifikave, të cilët mund të riaplikojnë për financim pranë FZHR, në këtë thirrje, ku vlera nuk kufizohet nga “tavani” sipas pikës 2.1. “a”.



partneriteti, të lidhur midis agjencisë/Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe dy ose më shumë njërive të qeverisjes vendore.

- 2.2. Në rastet e projekteve me disa përfitues nën skemat e partneritetit ndërvendor dhe rajonal ose në raste të tjera të veçanta, në marrëveshjen e partneritetit midis përfituesve caktohet autoriteti kontraktor që i propozohet Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për miratim. Komiteti miraton me vendim autoritetin kontraktor për zbatimin e projektit.

ANEKSI 3:

KALENDARI I AKTIVITETEVE, DREJTIMI “MBËSHTETJE PËR EKONOMINË”, Granti 3: “Mbështetje për ekonominë, dhe masa të tjera”

1. Hartimi i programit, përcaktimi i drejtimeve të financimit, dhe propozimi për miratim pranë Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, të bëhet jo më vonë se data 29 Maj 2016.
2. Hartimi i akteve nënligjore (VKM) për grantin, sipas aneksit 3/2, të ligjit nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, pika 1, gërma “a”, dhe paraqitja për miratim në Këshill të Ministrave, të bëhet jo më vonë se data 15 Qershor 2016.
3. Vendimi i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për shpërndarjen e Grantit 3: “Mbështetje për ekonominë, dhe masa të tjera”, të bëhet jo më vonë se data 20 Qershor 2016.
4. Të informohet Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, për ecurinë e procesit dhe pikave 1, 2 dhe 3, si më sipër.



Shtojcë I: KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në "Fletoren Zyrtare"	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekte të reja në grantin, programin dhe shtyllën e financimit, sipas pikës 1 dhe 2, të këtij vendimi.
29 Maj 2016 (afat për projektet e pikës 1)	Aplikuesit sipas Aneksit 1 të këtij vendimi, si më sipër.	Dërgimi e aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi online në faqen elektronike të e-albania: Shërbimi: Aplikimi online për FZHR https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203 .
20 Qershor 2016 (afat për projektet e pikës 2)	Aplikuesit sipas Aneksit 2 të këtij vendimi, si më sipër.	Ose 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (në CD) dërgohet pranë sekretariatit teknik përkatës, si më poshtë vijon: a) Shtylla 1 - "Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale", - granti 1: "Infrastruktura vendore dhe rajonale", sekretariati teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban Pranë Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, <u>nuk dorëzohen dosjet e aplikimit, por vetëm pranë sekretariatit teknik.</u>
5 ditë pune nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik përkatës	Vlerësimi i projekteve të aplikuara, bëhet sipas pikës A, shtojca III.
	Sekretariati teknik përkatës	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve që propozohen për financim.
5 ditë pune nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Zhvillimit dhe Planifikimit Strategjik)	Në bashkëpunim me sekretariatit teknik, organizon mbledhjen e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

**Shtojcë II:****FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTET****Ky format plotësohet për të gjitha projektet**

Aplikuesi (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Data e aplikimit (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Titulli i projektit (*)	
Shtylla e Financimit (*)	Të përcaktohet për cilën shtyllë aplikohet. (sipas Aneksit 3 të Ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”)
Programi i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin program aplikohet. (sipas Aneksit 3 të Ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”)
Granti i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin grant aplikohet (sipas Aneksit 3 të Ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”)
Data e fillimit të projektit (*)	
Data e mbarimit të projektit (*)	
Shtirrja hapësinore e projektit ☐ Lokal ☐ Ndërlokal ☐ Rajonal ☐ Ndër-rajonal	Në rastet kur aplikuesi është bashki shtrirja e projektit mund të jetë lokale ose rajonale kur projekti shtrihet në më shumë se një bashki. Në rastet kur aplikuesi është agjensi zhvillimi rajonal, shtrirja hapësinore do të jetë rajonale ose ndër-rajonale kur projektet i tejkalojnë kufijtë e rajonit aplikues. Për aplikimet, për projektet e pikës 2, të këtij vendimi, njësitë e qeverisjes vendore, duhet të bashkëngjisin në aplikim, edhe marrëveshjen e partneritetit të lidhur midis 2 apo më shumë bashkive. Për aplikimet, për projektet e pikës 2, të këtij vendimi, agjencitë aplikuese duhet të bashkëngjisin në aplikim, edhe marrëveshjen e partneritetit të lidhur midis tyre dhe 2 apo më shumë bashkive.
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmblotur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendndodhja e objektit të investimit; - Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistues (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt; - Përshkrimi i punimeve/ndërrhyrjeve të reja (sistem ngrohjeje, mur rrethues etj.) në objektin ekzistues (nëse ka); - Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij; - Risqet për zbatimin e tij; Informacion i qartë në lidhje me pronësinë e tokës (nqs parashikohet ndërtimi i një objekti të ri), nëse krijon vonesa në zbatimin e punimeve, krijon kosto shtesë (kosto e shpronësimit), kush e mbulon koston e shpronësimit.
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë që përfiton drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit në total. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesi.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 projekti për të njëjtin program, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar e kështu me radhë).



Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet, nëse për këtë projekt aplikuesi parashikon dhe deklaron (në formular) se mbulon: - Koston për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga njësitë qendrore, njësitë vendore apo nga donatorë, kostoja që kërkohet është e njëjtë me koston totale të projektit.
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësia e qeverisjes vendore	Paraqitni nivelin e bashkëfinancimit, në rast se projekti ka bashkëfinancim nga njësi qendrore, vendore, donatorë apo nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Financim nga donatorë (opsionale, nqs ka donatore)	Të jepet vlera e bashkëfinancimit në monedhën lekë.
Kostoja totale e projektit (*)	
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (Opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë
Deklarime. (*)	Aplikanti deklaron se: i. projekti është gati për zbatim (pra nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimin i punimeve; ii. Projekti është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara nga institucioni përkatës, është pjesë e planeve vendore të zhvillimit, dhe/ose të investimeve. Me miratimin e financimit, autoriteti kontraktues siguron pajisjen me të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit, sipas legjislacionit të fuqi. iii. Janë zbatuar cmimet e referencës dhe legjislacioni në fuqi për përllogaritjen e koston dhe vlerës financiare të projektit.
Dokumentet teknike, etj. (*)	Të sqarohet nëse projekti përmban: - projektin teknik/projektin e zbatimit - preventivin - argumentimin teknik
Koordinatat e projektit (*)	Të hidhen koordinatat e vendodhjes së projektit, sipas sistemit të gjeoreferencuar, në formë teksti
Foto – Gjendja ekzistuese (*)	Imazhe në formatin .jpeg ose .pdf
Pamje 3 Dimensionale (*) i detyrueshem pervec programit Shqiperia Dixhitale	Imazhe në formatin .jpeg ose .pdf

SHËNIM: Dërgimi i Aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:

- Aplikimi online në faqen elektronike të e-albania. Shërbimi: Aplikimi online për FZHR (<https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203>.)
Ose
- Me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit të hedhur në CD, pranë sekretariatit teknik përkatës.

**Shtojca III:****KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE QË PROPOZOHEN PËR FINANCIM (Shtylla 1 e Financimit: Zhvillimi Vendor dhe Rajonal)****A. Kriteret e vlerësimit teknik për projektet**

Këto kritere përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi, maksimalisht, me 90 pikë**. Kriteret 1, 2 dhe 3, detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik i ngritur pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, sipas aneksit 3, të ligjit nr.147, datë 17.12.2015 ligjit nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”.

Kriteret për vlerësimin teknik të projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore, ose agjencitë e zhvillimit. Ky kriter vlerësohet nga **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.
2. Përputhja me drejtimit e thirrjes dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.
3. Ndikimi i projektit në promovimin e potencialeve të qyteteve, lehtësimin e aksesit dhe ndërveprimin midis zonave urbane e rurale, promovimin e karakterit policentrik në qytetet e mëdha dhe pikat e interesit/referencë, nxitjen e zhvillimit të ekonomisë lokale dhe vlerës së shtuar, ndikimit në shërbimet publike ndaj qytetarëve dhe biznesit, cilësinë e jetës së qytetarëve dhe jetës komunitare, dhe zhvillimin ekonomik-sociale, dhe aksesin dhe infrastrukturën e ndërveprimit ekonomik, etj. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.
4. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.
5. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. Ky kriter vlerësohet me **me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë**.
6. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore apo fondet e donatorëve. Ky kriter vlerësohet me **me pikë nga 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë**.

B. Kriteret e vlerësimit të impaktit

Sekretariati i Përgjithshëm kryen vlerësimin e impaktit të përgjithshëm të projektit, **me pikë nga 0 deri në maksimalisht, 10 pikë**.

SHËNIM – Procesi i vlerësimit

1. Vlerësimi teknik, ligjor, dhe financiar i projekteve, në zbatim të Ligjit për buxhetin, dhe vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, kryhet nga sekretariati teknik, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, sipas kriterëve teknike të përcaktuara në shtojcën III, bashkëlidhur vendimit.
2. Sekretariati teknik i paraqet Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, listën e plotë të projekteve që propozohen për financim, në përfundim të procesit të vlerësimit.
3. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në bashkëpunim me sekretariatin teknik, merr masat për organizimin e mbledhjes së Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas komunikimit zyrtar të sekretariatit teknik.



VENDIM
Nr. 22, datë 18.4.2016

**PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT PËR
VITIN 2016, PËR DISA PROJEKTE NË
VAZHDIM TË GRANTIT
“INFRASTRUKTURA VENDORE DHE
RAJONALE”, PROGRAMI I ZHVILLIMIT
VENDOR DHE RAJONAL, SHTYLLA I**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim me cikël financimi 2015–2016, për grantin “infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Fondi i përfutur nga diferenca midis vlerës së projektit, miratuar sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve dhe vlerës së kontratës, pas nënshkrimit të kontratës, për projektet me cikël financimi 2015–2016, sipas pikës 1 të këtij vendimi, i shtohet portofolit të

grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, Programi i Zhvillimit Vendor dhe Rajonal, shtylla I, për vitin 2016. Ky fond shpërndahet për financimin e projekteve të thirrjes II, për vitin 2016, të grantit për infrastrukturën vendore dhe rajonale.

3. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar,
Ministri i Financave	anëtar,
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar,
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar,
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar,
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar,
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar,
Ministri i Shëndetësisë	anëtar,
Ministri i Kulturës	anëtar,
Ministri i Mjedisit	anëtar,
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar,
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar,
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar,
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Lista e disa projekteve me cikël financimi 2015–2016, granti infrastruktura vendore dhe rajonale, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, financimi për vitin 2016.

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vendimi i KZHR	Vlera e projektit (në lekë)	Vlera e kontratës (në lekë)	Vlera e “kursyer” pas lidhjes së kontratës (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
QARKU DURRËS									
1	Bashkia Durrës	Rikualifikim fasada	nr. 39 datë 16.10.2015	100,000,000	58,914,924	41,085,076	20,000,000	38,914,924	-
2	Bashkia Durrës	Rikonstruksion, rruga Perlat-Hamallaj- Hidrovor	nr. 39 datë 16.10.2015	120,000,000	74,764,272	45,235,728	24,000,000	50,764,272	-
QARKU FIER									
3	Bashkia Divjakë	Projekti unaza bujqësore “Mertish - 3 Urat”	nr. 39 datë 16.10.2015	418,233,618	380,571,137	37,662,481	41,823,362	150,542,647	188,205,128
4	Bashkia Divjakë	Projekt i “Rrugës Gradisht - Spolat i Madh”	nr. 39 datë 16.10.2015	160,388,123	131,986,708	28,401,415	16,038,812	115,947,896	-
5	Bashkia Fier	Rikonstruksion i rrugës “Mujo Ulqinaku” dhe rehabilitimi i fasadave të saj	nr. 39 datë 16.10.2015	246,173,029	237,591,722	8,581,307	24,617,303	124,352,129	88,622,290
6	Bashkia Fier	Rikonstruksion i rrugës Agim-Ndernenas-Hasturkas, Libofshe ,Fier	nr. 39 datë 16.10.2015	291,753,817	291,000,000	753,817	29,175,382	156,793,244	105,031,374



7	Bashkia Lushnjë	Projekti i sistemit afaltim i rrugës karbunare e vogël – zgjaner – ura Bicakaj – Qerrage (5.2 km gjatësi)	nr. 39 datë 16.10.2015	120,005,657	116,412,324	3,593,333	12,000,566	104,411,758	-
QARKU KORÇË									
8	Bashkia Maliq	Sistemit asfaltim i rrugëve të brendshme fshati Maliq	nr. 39 datë 16.10.2015	51,212,904	35,979,114	15,233,790	10,242,581	25,736,533	-
QARKU VLORE									
9	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitimi i Rrugës Transballkanike, fazat I dhe II (lidhja e Rrugës Transballkanike me superstradën Fier-Vlorë), si dhe kryerja e punimeve për sistemin e ndriçimit, gjelbërimit dhe trotuareve të rrugës Transballkanike	nr. 32 datë 15.07.2015	122,988,150	122,647,751	340,399	49,195,260	73,452,491	-
10	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i rrugës “Dhimitër Konomi”, Vlorë	nr. 39 datë 16.10.2015	492,863,190	440,177,621	52,685,569	98,572,638	183,888,762	157,716,221
TOTALI				2,123,618,488	1,890,045,572	233,572,916	325,665,904	1,024,804,656	539,575,013

Shënim.

1. “Vlera e projektit” përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

2. “Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të miratuar nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, dhe “korrekton” vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).

3. “Vlera e kursyer pas lidhjes së kontratës”, përfaqëson vlerën e përfutur nga diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës. Fondi i krijuar nga kjo diferencë i shtohet fondit të grantit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, dhe shpërndahet për financimin e projekteve të thirrjes II, për vitin 2016, të grantit për infrastrukturën vendore dhe rajonale.

4. “Vlera e financimit për vitin 2015” tregon vlerën e alokuar për vitin 2015, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. “Vlera e financimit”, për vitin 2016, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së financimit për vitin 2015.

6. “Vlera e financimit”, për vitin 2017, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së financimit për vitin 2015 dhe 2016.

**VENDIM****Nr. 23, datë 18.4.2016**

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT
PËR PROJEKTE TË GRANTIT
“SHËNDETËSIA”, THIRRJA E PARË,
PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË
INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE
RAJONALE, SHTYLLA I, PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte të reja, thirrja e parë, për vitin 2016, për grantin e shëndetësisë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor), programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, sipas tabelës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Autoriteti kontraktues, projekti i të cilit miratohet për t’u financuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesë në sekretariatit teknik, pranë Ministrisë së Shëndetësisë, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve, si dhe emrin e personit përgjegjës për informim.

3. Autoriteti kontraktues, për projektin sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të kryejë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të

ndërtimit deri në fillim të tremujorit të tretë të vitit 2016. Për fondin e projektit të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën të rishqyrtojë financimin dhe ta rishpërndajë atë për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik në Ministrinë e Shëndetësisë, të kryejë monitorimin e ecurisë së përdorimit të fondeve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2 të këtij vendimi, dhe të informojë Ministrinë e Financave, dhe periodikisht Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Ngarkohen ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETARI**Niko Peleshi**

Zëvendëskryeministri

Ministri i Financave

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,

Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ministri i Zhvillimit Urban

Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

Ministri i Arsimit dhe Sportit

Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe

Administrimit të Ujërave

Ministri i Shëndetësisë

Ministri i Kulturës

Ministri i Mjedisit

Ministri i Punëve të Brendshme

Ministri i Shtetit për Inovacionin

dhe Administratën Publike

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore

Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë

Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /

Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1

Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /

Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2

Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3

Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4

Zëvendëskryetar,
anëtar;

anëtar

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar;

anëtar.

Tabela 1. Lista e projekte të reja për financim, thirrja e parë, përmes grantit të shëndetësisë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor), Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, për vitin 2016.

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i Projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
1	Bashkia Kamzë	Rikonstruksioni i Qendrës Shëndetësore, në Bashkinë Kamzë	83,873,529	13.185.209	70.688.320
	TOTALI		83,873,529	13.185.209	70.688.320






Tabela 1. Lista e projekteve të reja për financim, thirrja e parë, përmes grantit të rehabilitimit mjedisor, gjelbërimit dhe pyllëzimit, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, për vitin 2016

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i Projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
1	Bashkia Kolonjë	Gjelbërimi i Mjedisave Publike të Bashkisë Kolonjë, qyteti Ersekë, në veprat: “Monumenti i Rilindjes”, Rruga “R&S Gostivisht”, Rruga “20 Maji” dhe Rruga “Martirët e Borovës”	42,000,000	42,000,000	-
2	Bashkia Skrapar	Pyllëzimi i kurorës së qytetit Çorovodë në objektin Kaloç	8,000,000	8,000,000	-
3	Bashkia Përmet	Gjelbërimi i mjedisave publike të Bashkisë Përmet, në veprat: Rruga “Spital -Varrezat Publike”, Rruga “Hotel Ramizi – Spital”, Rruga Tomor Mullaraj”, Rruga “Laver Bariu”, Shëtitorja “Sami Frashëri”, Shëtitorja “Kongresi i Përmetit” dhe Shëtitorja “Mentor Xhemali”	10,000,000	10,000,000	-
4	Bashkia Fier	Gjelbërimi i mjedisave publike të Bashkisë Fier, në veprat: Unaza e qytetit Fier dhe anët e Lumit Gjanica	30,000,000	30,000,000	-
TOTALI			90,000,000	90,000,000	-

Shënim.

1. Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga autoritetet kontraktuese). Kjo vlerë shërben si referencë për përlogaritjen e vlerës së financimit për vitin 2016, dhe korrektohet nga vlera e kontratës, pas nënshkrimit të saj. Fondi i përfutur nga diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës, pas nënshkrimit të kontratës, i shtohet portofolit të grantit “Rehabilitimit mjedisor, gjelbërimit dhe pyllëzimit”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, dhe shpërndahet për financimin e projekteve të reja. Vlera e plotë e projektit përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Mjedisit).

2. “Vlera e financimit për vitin 2016” tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016.

3. “Vlera e financimit”, për vitin 2017, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së financimit për vitin 2016.

**KËRKESË****Nr. 1575/5, datë 12.4.2016****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga vendosja e servitutit për ndërtimin e Korridorit të Sistemit të Gazsjellësit dhe Korridori i ndërtimit në zonat Fier, Korçë, Devoll, Berat dhe Lushnjë (pjesë e projektit të gazsjellësit “Trans Adriatik”). Subjekti kërkuar i kësaj kërkesë është Trans Adriatic Pipeline Ag Shqipëri, shoqëri e cila do zhvillojë një tubacion të gazit natyror, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, sipas listave emërore bashkëlidhur, mbi masën e vlerësimit të llogaritur në zbatim të ligjit të posaçëm nr. 116/2013, datë 15.4.2013, në përputhje me planin e rehabilitimit të jetesës.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në listat emërore të publikuara, por nuk figurojnë në këto lista, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës. Lutemi pronarëve dhe personave që pretendojnë pronësinë mbi pasuritë që preken nga ky projekt, të dorëzojnë çdo dokument që disponojnë pranë ZVRPP-së përkatëse për shënimet e bëra nga ZVRPP-të në listën bashkëlidhur, mbi saktësimin dhe konfirmimin e sipërfaqeve, mungesat e dokumentacionit etj.

**ZËVENDËSMINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
Iliir Bejtja**



RRETHET; KORÇË, DEVOLL, SKRAPAR, BERAT, FIER DHE LUSHNJË
LISTA E PRONARËVE TË CILËT PREKEN NGA SISTEMI I GAZSJELLËSIT

Nr.	Pronari/Përdoruesi			Z.K.	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. m ² për marrje në përdorim të përkohshëm	Çmimi/m ²	Vlera lekë	Sip. m ² Servitut	Çmimi/m ²	Vlera lekë	Vlera totale e kulturave	Objekte vlera lekë	Vlera e tokës jetime	Vlera totale lekë	Indeksi i hartës	Shënime
1	Edeva	Teki	Koroli	3804	1121/15	Arë	231.00	161.50	37,306.50	52.00	323.00	16,796.00	5,082.00			59,184.50	K-34-126-(48-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Xhemile	Emin	Reçi	3804	239/34	Arë	258.00	161.50	41,667.00	54.00	323.00	17,442.00	5,676.00			64,785.00	K-34-126-(48-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Satber	Demir	Bajraktari															
	Avzi	Demir	Reçi															
	Xhevdet	Demir	Reçi															
3	Yldes	Demir	Bajraktari	3804	1136/36	Arë	243.00	161.50	39,244.50	70.00	323.00	22,610.00	32,503.68			94,358.18	K-34-126-(A-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Hashi	Ali	Collaku	3804	239/32	Arë	260.00	161.50	41,990.00	55.00	323.00	17,765.00	5,720.00			65,475.00	K-34-126-(48-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Servet	Rakip	Hoxha	3804	239/13	Arë	269.00	161.50	43,443.50	56.00	323.00	18,088.00	5,918.00			67,449.50	K-34-126-(48-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Fitret	Sali	Sala															
	Remzije	Ilmi	Sala															
	Marjeta	Ilmi	Hanelli															
6	Engjellush	Ilmi	Sala	3804	1136/37	Arë	303.00	161.50	48,934.50	71.00	323.00	22,933.00	6,666.00			78,533.50	K-34-126-(48-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Nevrije	Zagur	Collaku															
7	Syrja	Ali	Graca	3804	239/28	Arë	330.00	161.50	53,295.00	94.00	323.00	30,362.00				83,657.00	K-34-126-(48-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Arben		Graca										272,530.50			272,530.50		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
	Zarif	Veli	Spaho				355.00	161.50	57,332.50	81.00	323.00	26,163.00				83,495.50		Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Saliko	Qemal	Berberi	3804	239/20	Arë	406.00	161.50	65,569.00	86.00	323.00	27,778.00	13,812.12			107,159.12	K-34-126-(48-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	Qerim	Kasem	Reçi	3804	239/33	Arë	427.00	161.50	68,960.50	90.00	323.00	29,070.00				98,030.50	K-34-126-(48-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	Fatime	Abidin	Berberi	3804	241/6	Arë	530.00	161.50	85,595.00	64.00	323.00	20,672.00	11,660.00			117,927.00	K-34-126-(48-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	Neim	Hadil	Spaho	3804	239/7	Arë	491.00	161.50	79,296.50	105.00	323.00	33,915.00	16,703.82			129,915.32	K-34-126-(48-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	Bexhet	Ramadan	Grucko	3804	239/22	Arë	505.00	161.50	81,557.50	106.00	323.00	34,238.00	17,180.10			132,975.60	K-34-126-(48-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
14	Edmond	Hysni	Shehu	3804	239/9	Arë	478.00	161.50	77,197.00	136.00	323.00	43,928.00	394,756.30			515,881.30	K-34-126-(48-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
15	Arben	Bashkim	Buci	3804	239/16	Arë	508.00	161.50	82,042.00	107.00	323.00	34,561.00	17,282.16			133,885.16	K-34-126-(48-B)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
16	Petrit	Avni	Shurdho	3804	1135/8	Arë	596.00	161.50	96,254.00	31.00	323.00	10,013.00	13,112.00			119,379.00	K-34-126-(48-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Fitnet	Refa	Ajçe															
	Bashkim	Jashar	Ajçe															
	Aferdita	Jashar	Grobali															
17	Ilmi	Jashar	Ajçe	3804	1136/61	Arë	552.00	161.50	89,148.00	86.00	323.00	27,778.00	12,144.00			129,070.00	K-34-126-(A-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Rahmi	Nazif	Bregu															
18	Vasil	Xhevdet	Ajçe	3804	1136/51	Arë	556.00	161.50	89,794.00	117.00	323.00	37,791.00	8,340.00			135,925.00	K-34-126-(48-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Alfred	Xhevdet	Ajçe															
19	Aishe	Ahmet	Piring	3804	1124/18	Arë	683.00	161.50	110,304.50	145.00	323.00	46,835.00	17,075.00			174,214.50	K-34-126-(48-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Alfred	Nexhmi	Piring															
	Rovena	Nexhmi	Piring															
	Muhazes	Nexhmi	Muzikanti															
	Alush	Nexhmi	Piring															
	Mimoza	Irfan	Piring															
	Elvis	Alfred	Piring															
	Emiljana	Alfred	Piring															
	Ornela	Alfred	Piring															
	Fuat	Zenel	Agolli															
21	Xhevdet	Demir	Reçi	3804	242/80	Arë	974.00	161.50	157,301.00				21,428.00			178,729.00	K-34-126-(48-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
22	Demir	Ali	Dervishi	3804	239/36	Arë	814.00	161.50	131,461.00	172.00	323.00	55,556.00				187,017.00	K-34-126-(48-D)	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
23	Snoj	Nafi	Mulla	3804	242/83	Arë	626.00	161.50	101,099.00	409.00	323.00	132,107.00				233,206.00	K-34-126-(48-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
24	Memedali	Emin	Graca	3804	239/37	Arë	861.00	161.50	139,051.50	180.00	323.00	58,140.00	18,942.00		85,694.50	301,828.00	K-34-126-(48-D)	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
25	Nekton	Shahin	Piring	3804	239/25	Arë	896.00	161.50	144,704.00	189.00	323.00	61,047.00	19,712.00			225,463.00	K-34-126-(48-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
26	Nekton	Shahin	Piring	3804	239/38	Arë	919.00	161.50	148,418.50	202.00	323.00	65,246.00	13,785.00			227,449.50	K-34-126-(48-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
27	Nekton	Shahin	Piring	3804	1124/21	Arë	828.00	161.50	133,722.00	309.00	323.00	99,807.00	738,386.40			971,915.40	K-34-126-(48-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
28	Fuat	Feti	Berberi	3804	241/8	Arë	1,346.00	161.50	217,379.00				29,612.00			246,991.00	K-34-126-(48-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
29	Remzi	Bajram	Revani	3804	1119/6	Arë	1,130.00	161.50	182,495.00	241.00	323.00	77,843.00	24,860.00			285,198.00	K-34-126-(48-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja



30	Nektor	Skender	Miza	3804	1121/19	Arë	1,477.00	161.50	238,535.50	310.00	323.00	100,130.00	32,494.00			371,159.50	K-34-126-(48-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
31	Irfan	Haxhi	Miza	3804	1121/17	Arë	1,879.00	161.50	303,458.50	403.00	323.00	130,169.00	63,923.58			497,551.08	K-34-126-(48-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
32	Ali	Ideal	Bakalli	3804	1124/20	Arë	1,874.00	161.50	302,651.00	470.00	323.00	151,810.00	41,228.00			495,689.00	K-34-126-(48-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
33	Luan	Nazif	Koblara	3804	1119/1	Arë	2,228.00	161.50	359,822.00	469.00	323.00	151,487.00	49,016.00			560,325.00	K-34-126-(47-B)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
